

RAMI MEMUSHAJ

SINTETIZMI SI TIPAR I PROCESIVE FJALËFORMUESE
NË GJUHËN SHQIPE

1. Analitizmi dhe sintetizmi në gjuhë janë parë përgjithësisht të lidhur me trajtëformimin. Ky konceptim i ngushtë zë fill me August Shlegelin, me të cilin lidhet klasifikimi tipologjik i gjuhëve në izoluese, aglutinative (me afikse) dhe flektive. Nevoja për të bërë dallimin midis gjuhëve flektive me eptim shumë të zhvilluar, si sanskritishtja, greqishtja e vjetër e latinishtja, nga gjuhë pa eptim emëror, si anglishtja e frëngjishtja, e shtyu Shlegelin t'i ndante gjuhët flektive në sintetike dhe analitike. Kështu, në veprën *Observations sur la langue et la littérature provençales* (1818), ai shkruan: “Gjuhë analitike janë ato që përdorin nyjën përpara emrave, përemrat vetorë përpara foljeve, që në zgjedhim përdorin foljet ndihmëse, parafjalët në vend të mbaresave rasore që u mungojnë, që shkallët e krahasimit të mbiemrave i shprehin me ndajfolje e kështu me radhë. Gjuhë sintetike janë ato që janë të privuara nga të gjitha këto mjete perifrazimi.”¹ Ndonëse për ndarjen e gjuhëve në analitike dhe sintetike Shlegeli merr si kriter mënyrën se si fjalët i ndërtojnë format e tyre, në veprën e sapocituar ai përmend edhe kompozimin, p.sh. kur thotë se sanskritishtja ua kalon gjuhëve të tjera sintetike “në aftësinë për të formuar fjalë të përbëra (des mots composés)”².

Ndikimi i këtij konceptimi të ngushtë të sintetizmit, që ka vijuar për një kohë shumë të gjatë në gjuhësinë botërore, vërehet edhe në gjuhësinë shqiptare. Në tekste akademike e universitare me këta terma kuptohet mënyra se si shprehet kuptimi gramatikor i fjalës, duke quajtur sintetike fjalëformat në të cilat “kuptimi gramatikor shprehet brenda kufijve të fjalës”, me mjete si ndajshitesat, ndërrimet e tingujve, theksi e dyfishimi, dhe analitike ato forma fjalësh që ndërtohen me folje ndihmëse, pjesëza dhe nyja të përparme³.

Mirëpo sintetizmi dhe analitizmi nuk vërehen vetëm në morfologjinë eptimore, po edhe në morfologjinë leksikore, në fjalëformimin e një gjuhe, gjë që në gjuhësinë e dy shekujve të shkuar më shumë është nënkuptuar. Vetëm në fillim të viteve '80 të shek. XX, Teo Venemani (Theo Vennemann) vuri në dukje se “procesi i sintezës ndodh atëherë kur kemi kompozim, dyfishim, ndajshitesim (parashtesim, brendashtesim, prapashtesim), mutacion (ndërrim

¹ A. W. Schlegel, *Observations sur la langue et la littérature provençales*, 1818, f. 16.

² *Po aty*, f. 17.

³ *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, Tiranë, 1976, f. 10–12; shih edhe F. Agalliu, R. Memushaj, M. Reso, *Hyrje në gjuhësi*, 1986, f. 284.

segmentesh, zanoresh, bashkëtingëlloresh, theksi dhe intonacioni) dhe reduktim”⁴. Edhe pse këtu nuk bëhet dallimi se cilat mjete përdoren për formimin e fjalëve dhe cilat për formimin e trajtave të fjalëve, përmendja ndër mjetet sintetike edhe e kompozimit, që nuk shërben si mjet trajtëformues, të shpie te fjalëformimi. Në gjuhësinë shqiptare, për sintetizmin në fjalëformim është shqiptuar në disa punime të tij A. Kostallari, i cili ka vënë në dukje mbizotërimin e *sufiksimit* dhe të *kompozimit* si mënyra derivimi të fjalëve në gjuhën shqipe.

2. Pra, sintetizmi duhet parë më gjerë, d.m.th. jo vetëm si mënyrë e shprehjes së kuptimeve gramatikore nga fjalëformat, por edhe e shprehjes së kuptimeve leksikore, d.m.th. edhe në fjalëformim. Megjithatë, midis sintetizmit në gramatikë dhe sintetizmit në leksik duhet bërë një dallim i qartë. Sintetizmi në gramatikë është rrjedhim i një procesi të gjatë evolucioni të një gjuhe, proces që nuk mund të shihet si një shkallë më e lartë në zhvillimin e saj, sikundër mendohej në shek. XIX, pasi ka plot shembuj të kalimit nga sintetizmi në analizëm, si p.sh. anglishtja ose gjuhët neolatine të Europës Perëndimore, që rrjedhin prej gjuhësh sintetike. Sintetizmi në fjalëformim mendojmë se ka si shkak kryesor ekonominë gjuhësore. Duke iu përbajtur parimit “me sa më pak mund”, i cili, sikundër ka provuar Xhorxh Zipfi, është një parim universal që “përcakton aspekte të rëndësishme të sjelljes njerëzore”⁵, përfshirë edhe gjuhën, folësi prirët t’i shkrijë fjalët e një sintagme në një fjalë të vetme. Sintetizmi në fjalëformim nuk është veçori vetëm e gjuhëve sintetike, ai haset edhe në gjuhë analitike. Në kinezishte, që, si gjuhë rrënjore, përfaqëson tipin *par excellence* të gjuhëve analitike, kompozitat përbëjnë një pjesë jo të vogël të leksikut të saj. Për shembull, emrat *Zhongguo*, *Beijing*, *Nanjing*, *zhunghuohua*, *Zhenminzhibao* etj. janë fjalë të përbëra: *Zhongguo* (kështu e quajnë kinezët vendin e tyre) përbëhet nga dy fjalë njërrrokëshe *zhong* ‘i mesëm’ dhe *guo* ‘shtet’, d.m.th. “shteti i mesëm”; *Beijing* (Pekin) nga rrënjët *bei* ‘veri’ dhe *jing* ‘qytet’, d.m.th. “qyteti i Veriut”; *Nanjing* (Nankin) nga *nan* ‘jug’ dhe *jing* ‘qytet’, d.m.th. “qyteti i jugut”; *zhunghuohua* “kinezishte” përbëhet nga tri fjalë: *zhong+guo* ‘Kinë’ + *hua* ‘gjuhë’, d.m.th. “gjuha e Kinës”; *Zhenminzhibao* (organ i PKK) është

⁴ Theo Vennemann, *Agglutination – Isolation – Flexion? Zur Stimmigkeit typologischer Parameter* në S. Heinz and U. Wandruszka (eds.), *Fakten und Theorien: Beiträge zur romanischen und allgemeinen Sprachwissenschaft: Festschrift für Helmut Stimm zum 65. Geburtstag*, Tübingen (Gunter Narr), 1982, f. 327–334..

⁵ G. K. Zipf, *Human Behaviour and the Principle of the Least Effort*, Addison-Wesley Press Inc., Cambridge, Massachusetts, 1949, f. V.

kompozitë me katër rrënjë: *renmin* (*ren* ‘njeri’ + *min* ‘popull’ dhe *ribao* (*ri* ‘ditë’ e *bao* ‘gazetë’, pra “e popullit e përditshme gazetë”⁶.

Më i dukshëm veprimi i parimit “me sa më pak mund” në fushën e leksikut vërehet te fjalët e përngjitura. Megjithatë, ky parim vepron edhe në mënyrat e tjera të fjalëformimit. Pikërisht, në këtë shkrim do të përqipemi të tregojmë se si shfaqet sintetizmi në fjalëformimin e shqipes. Për këtë do të mbështetemi në një korpus prej më shumë se 7 mijë njësisish të reja leksikore, të vjela gjatë një periudhe 4-vjeçare (2011–2014) nga shtypi i përditshëm e periodik dhe nga literatura artistike, shkencore, juridike etj. Ky numër fjalësh dëshmon për ritmin e lartë të pasurimit të gjuhës shqipe, që, sipas llogaritjeve tona, arrin në afro 5 fjalë në ditë. Ky ritëm relativisht i lartë shpjegohet me nevojën për të emërtuar sende, dukuri e koncepte të reja, por edhe me nevojën për fjalë me një shkallë më të lartë abstraksioni, që mund të përmbushet duke kaluar nga sintagma në njësi leksikore, d.m.th. duke kaluar nga ndërtime analitike në konstrakte sintetike. Pasurimi i leksikut si pasojë e këtyre dy trysnive dëshmon, nga njëra anë, se në rendjen për t’u ballafaquar me gjuhët e zhvilluara të Europës gjuha jonë po ecën me hapa të shpejtë. Për shembull, botimi i vitit 2015 i “Fjalorit drejtshkrimor të gjuhës shqipe” ka 6 mijë njësi leksikore më shumë se botimi i vitit 2011, prej të cilave shumicën dërrmuese e përbëjnë fjalët e prejardhura dhe të përbëra. Pasurimi i shpejtë i leksikut të shqipes me këto grupe fjalësh dëshmon se shkalla e intelektualizmit të saj është në rritje, duke e bërë gjuhën tonë të aftë për të përballuar nevojat e shprehjes në stilet e larta të veprimtarisë ligjërimore.

Është e kuptueshme se nevojat për njësi të reja leksikore nuk mund të përmbushen vetëm me fjalë rrënjë, as me fjalë të krijuara me një mënyrë të caktuar fjalëformimi. Për këtë qëllim përdoren gjedhet dhe tipat e fjalëformimit më prodhues të gjuhës shqipe, siç do të përqipemi ta provojmë të mbështetur në korpusin e fjalëve të reja të Fjalorit tonë drejtshkrimor.

3. Duke folur për strukturën fjalëformuese të gjuhës letrare shqipe, A. Kostallari si veçori themelore të normës së saj fjalëformuese sheh mbizotërimin e theksuar të prapashtesimit e të kompozimit. Sipas tij, “këto mënyra fjalëformuese me krijimin e njërive leksikore-semantike kompakte ndikojnë për forcimin e prirjeve sintetike edhe në strukturën gramatikore”⁷. Kjo prirje sintetizuese në fjalëformimin e shqipes standarde të cilën ai jo një

⁶ Struktura binare e kompozitive vërtetohet edhe për kinezishten, siç duket te *zhongguohua*, e formuar nga tema e përbërë *zhongguo* dhe tema e thjeshtë *hua* dhe te *zhenminzhibao*, e formuar nga dy tema të përbëra: *zhenmin* dhe *zhibao*.

⁷ A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, Studime filologjike, 1970, 2, f. 37.

herë e ka vënë në dukje⁸, ka ardhur duke u forcuar gjithnjë e më shumë, duke i bërë këto dy mënyra fjalëformimi nga më prodhueset në shqipe, gjë që vërtetohet edhe nga lënda e korpusit të fjalëve që po marrim në shqyrtim.

Ndër prejardhjet e formuara me prapashtesim, mbizotërojnë ndajfoljet me *-(r)isht*, pastaj ato me *-shëm* dhe rrallë me *-thi*, që mund të shihen si forma sipërfaqësore të formave të thella të ndërtuara me sintagma parafjalore të tipit *me + emrin* që shërben si temë fjalëformuese; *në* dhe *nga* + sintagmë emërore me modifikues mbiemrin që shërben si temë fjalëformuese, ose sintagmë lidhëzore me kokë lidhëzën krahasore *si + emrin* që shërben si temë fjalëformuese. Të tilla janë ndajfoljet *abuzivisht* “në mënyrë abuzive”, *akrobatikisht*, *dëshpërimisht* “me dëshpërim”, *enigmatikisht*, *etimologjikisht* “nga pikëpamja etimologjike”, *gravitacionalisht*, *higjienikisht*, *hiperbolikisht*, *intuitivisht*, *kohësisht*, *krahasimisht*, *finokërisht*, *kërcënueshmërisht*, *kryeneçësisht* / *kryeneçërisht*, *kthjelltësisht*, *kulturalisht* / *kulturorisht* “nga pikëpamja kulturore”, *kushtetutshmërisht*, *legjitimisht*, *majmunisht*, *mediatikisht*, *mitologjikisht*, *mjaftueshmërisht*, *modestisht*, *ndërkombëtarisht*, *ngulmërisht* “me ngulm”, *ngjashmërisht*, *ngjethshmërisht*, *optimalisht*, *pafajësisht*, *pafajshmërisht*, *paligjshmërisht*, *pamendueshmërisht* “në mënyrë të pamendueshme”, *pandërgjegjshmërisht*, *papërgjegjshmërisht*, *papërshtatshmërisht*, *pastërtisht*, *paudhësisht*, *pedantisht*, *perëndisht*, *përbarazisht*, *përshtatshmërisht*, *princërisht*, *regresivisht*, *skandalisht*, *sociologjikisht*, *solidarisht*, *strukturalisht*, *shpirtmadhërisht*, *tejskajshmërisht*, *trishtueshmërisht* etj.

Një grup tjetër, po më të vogël, e përbëjnë ndajfoljet e formuara me prapashtesën *-shëm* kryesisht nga tema emërore, por edhe nga tema foljore. Të tilla janë *humnershëm*, *kaltërueshëm*, *ngjethshëm*, *përdhunshëm*, *suksesshëm*, *shpërfillshëm*, *tërbueshëm*, *urrejtshëm* etj. Si forma të thella të këtyre ndajfoljeve shërbejnë sintagma parafjalore me kokë parafjalën *me + emër*, si te *përdhunshëm* “me përdhunë”, *suksesshëm* “me sukses”, *shpërfillshëm* “me shpërfillje”, *urrejtshëm* “me urrejtje”; por ka edhe forma të tjera të thella, si p.sh. *humnershëm* “si në humnerë”, *ngjethshëm* “në mënyrë ngjethëse” etj.⁹

Kushdo që lexon a përkthen literaturë shkencore, ndeshet me fjalë të italishtes me prapashtesën *-itá*, të frëngjishtes me *-ité*, të anglishtes me *-ity* apo me *-ost* të rusishtes, të cilat shpeshherë e ka të vështirë t’i përkthejë, pasi për to gjuha shqipe nuk ka fjalë përgjegjëse, gjë që dëshmon se gjuha jonë nuk e ka arritur shkallën e duhur të përkthyeshmërisë, e cila është një nga

⁸ A. Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, SF, 1982, 2, f. 24.

⁹ Një studim shterues i një korpusi ndajfoljesh të formuara me prapashtesa, që përfshin lëndë leksikore deri në vitin 2003, është monografia e J. Thomait “Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe” (2004).

tiparet që e fiton një gjuhë standarde në fazën e kultivimit. Pikërisht, në këtë fazë të zhvillimit të shqipes, vërejmë se në të po shtohen emrat abstraktë të formuar me prapashtesat *-(ë)ri* dhe *-(ë)si* që përdoren në fushën e shkencave, për të cilët ajo është ndier deficitare. Kështu, në korpusin e vjelë, me këto prapashtesa janë formuar fjalët *bindshmëri* “të qenët i bindur”, *dëshirueshmëri*, *fajësueshmëri*, *faktueshmëri*, *fitueshmëri*, *halabakëri* “veprim a sjellje prej halabaku; tërësi halabakësh”, *jetimëri*, *shpirtkazmëri*, *kuptimshmëri*, *patundshmëri*, *plotësueshmëri*, *pranueshmëri*, *vetëmjaftueshmëri* dhe *alkalinësi*, *bajraktarësi*, *barasvlerësi*, *çeltësi* “të qenët i çelët, i hapur”, *dakordësi*, *dymendësi*, *fjalëshkurtësi*, *gjithëkohësi*, *hundëpërprjetësi*, *ilirësi* (në vend të iliricitet), *keqbërësi*, *këndorësi* “këndi i shikimit të një ekrani”, *kokëboshësi*, *kryeligësi*, *mëmësi* “të qenët nënë e një fëmije; lidhje e gjinisë apo e qumështit”, *parapamësi*, *përtashësi*, *sistemësi*, *shumëfjalësi* “të përdorurit e fjalëve të shumta”.

Në pak raste, nevoja për emërtime abstrakte njëfjalëshe në vend të sintagmave shumëfjalëshe është përmbushur duke përdorur prapashtesa të huaja që nuk janë më aktive, si *-istikë*, *-itet* e *-llëk*, me të cilat janë formuar fjalët *informacionistikë* për “teknologji numerike”, *mashkulloritet* për “mashkulli”, *ministërrllëk* “të qenët ministër” e *drejtorllëk* “të qenët drejtor”. Nga këto, fjala e parë duket e pagoditur, e dyta një formim i panevojshëm; kurse dy të fundit me ngarkesë stilistike negative.

Një klasë tjetër fjalësh të prejardhura janë përftuar nga njëfjalësimi i sintagmave emërore, si pasojë e shtimit të prapashtesave *-ësh/-ëshe* dhe *-shëm*, por edhe e prapashtesave të tjera, që japin mbiemra. Nga këto prapashtesa, *-ësh* u shtohet sintagmave emërore me caktuesor një numëror a ndajfolje sasive, duke dhënë mbiemra të panyjshëm që me konversion kthehen në emra, ndërsa prapashtesa femërorizuese *-(ë)she* formon emra: *disaburimësh* (<disa burim(e) + sh), *katërkubikësh* (katër kubikë + sh) “motor katërkubikësh”, *njëmijëdollarësh*, *njëmijëlitërsh*, *njëmijësterlinësh*, *njëmiliondollarësh*, *njëpërdorimësh*, *njëqindditësh*, *njëqindetridhjetëvatësh*, *njëqindkrerësh*, *qindramilionësh*, *pesëmbëdhjetëpërqindësh*, *shumëpërdorimësh* dhe *shumëpërmasësh*; *njëmijëllirësh*, *njëmorfemësh*. Kurse *-shëm* si pjesë e rrethshesës *i/e... -shëm* u shtohet sintagmave emërore, parafjalore a ndajfoljore, duke dhënë kryesisht mbiemra, si: *i njëpalshëm* (një palë), *i njëmijëllojshëm* (një mijë lloje), *i tjetërbotshëm* (tjetër botë), *i shumëfrytshëm* (*shumë fryte*), *i shumëmënyrshëm* (*shumë mënyra*), *i përtremuajshëm* (për tre muaj), *i pakmëparshëm* (pak më parë), *i kotsëkotshëm* (kot së koti), *i happashapshëm* (hap pas hapi).

Të ngjashëm me mbiemrat që sapo numëruam janë edhe *i shumëfrytshëm*, *i nëndorëpaguar* (R. Qosja), *i shumëherëpërgojuar* (E. Rama), *i aqshumëdëmtuar*, *i aqshumëgjakosur* (kosovarëve të

aqshumëdëmtuar e të aqshumëgjakosur), *i aqshumëkërkuar* (ndryshime të aqshumëkërkua), *i aqshumëpërfolur*, *i kudondodhshëm*, *i kudopranishëm*, *i kudotymosur*, *i mirëpërgatitur* (strategji e mirëpërgatitur), *i mirëplanifikuar*, *i mirërregulluar* (sektor bankar i mirërregulluar), *i mirësaktësuar* dhe *i anashshpërndarë*. Por ngjashmëria e këtyre dy klasave të mbiemrave është vetëm në strukturën sipërfaqësore. Në strukturën e thellë ato ndryshojnë, pasi mbiemrat e klasës së dytë janë përfutur jo me rrethshesim si të parët, po nga përmbyjsja e rendit të përbërësve. Brenda kësaj klase dallohen disa nëntipa: një nëntip më vete e përbëjnë mbiemrat *i shumëfrytshëm* dhe *i shumëçmuar* të formuar nga sintagmat mbiemërore *shumë i frytshëm*, *shumë i çmuar* me lëvizje të specifikuesit (fjalës së shkallës) *shumë*, ashtu si *i shumënderuar* < *shumë i nderuar* (që gjendet në Fjalorin e 2006-ës) dhe *i shumëkërkuar* < *shumë i kërkuar*; një nëngrup tjetër e përbëjnë mbiemrat *i nëndorëpaguar*, *i shumëherëpërgojuar*, *i aqshumëdëmtuar*, *i aqshumëgjakosur*, *i aqshumëkërkuar*, *i aqshumëpërfolur*, *i kudondodhshëm*, *i kudopranishëm*, *i kudotymosur*, *i mirëpërgatitur*, *i mirëplanifikuar*, *i mirërregulluar*, *i mirësaktësuar*, *i rëndëngarkuar* dhe *i anashshpërndarë*, të përfutur nga përmbyjsja e rendit të përbërësve të sintagmave, i pari nga përmbyjsja e rendit të kokës mbiemërore dhe të sintagmës parafjalore që e plotëson (i nëndorëpaguar < i paguar nën dorë); ndërsa të tjerët nga përmbyjsja e rendit të kokës mbiemërore dhe të sintagmës ndajfoljore, pra *i aqshumëpërgojuar* < i përgojuar aq shumë, *i kudondodhur* < i ndodhur kudo, *i mirëpërgatitur* < i përgatitur mirë, *i anashshpërndarë* < i shpërndarë anash.

Me rrethshesim është formuar edhe *i mëpërparmë*, me rrethshesën *i...-më*, që ngërthen sintagmën *më përpara*; ndërsa te *i krejtrrokshëm*, në procesin e fjalëformimit, veç rrethshesës, kemi edhe përmbyjsjen e rendit të fjalëve të sintagmës foljore *rrok krejt*.

Njëfjalësime sintagmash parafjalore kemi te mbiemrat e formuar me nyjëzim, si *i paaguar* < pa aguar, *i pabrekë* < pa brekë. Njëfjalësim sintagmash emërore kemi te *njëprindëror* “që ka vetëm njërin nga prindët” (familje njëprindërore), nga *një prind* me prapashtesën *-or(e)*; te *burrështetas* e *qemalstafas*, përkatësisht nga *burrë shteti* dhe *Qemal Stafa* me prapashtesën *-as*; dhe te *dumbabist* (rebelim dumbabist) e *haxhiqamili*st përkatësisht nga *dum babën* përkatësisht *Haxhi Qamili* me prapashtesën *-ist*. Njëfjalësim sintagmash foljore kemi te *çartabukas*, *bjerrakohës* e *dalzotës* me prapashtesat *-as* dhe *-ës*: [çart bukën] + *-as*, [(i) dal zot] + *-ës*

Me ekonominë gjuhësore shpjegohet edhe krijimi i foljeve *çarteroj* < çarter + *-o-*, në vend të “marr çarter një avion, anije” dhe *gogolizoj* < gogol + *-izo-*, në vend të “bëj gogol dikë a diçka”.

Këto formime ndajshesore sjellin ekonomi nga pikëpamja nyjëtimore, sepse harxhohet më pak energji dhe më pak kohë për shqiptimin e tyre në

krahasim me sintagmat parafjalore gjegjëse; por, nga ana tjetër, ato shtojnë operacionet mendore, pasi, për të nxjerrë kuptimin e ndajfoljeve të prejardhura, folësit i duhet të gjejë formën e tyre të thellë. Zëvendësimi i sintagmave me një fjalë të vetme e rrit shkallën e abstraksionit në leksik dhe, për pasojë, rrit edhe shkallën e intelektualizimit të shqipes. Veç kësaj, formime të këtij lloji, pjesës më të madhe të të cilave në gjuhët e zhvilluara u përgjigjen gjithashtu fjalë dhe jo sintagma, rritin dhe shkallën e përkthyeshmërisë nga këto gjuhë në shqipe.

4. Përngjitja është mënyra e fjalëformimit ku vërehet më qartë prirja e sintetizimit. Ndryshe nga prejardhja dhe kompozimi, që janë mënyra të formimit të fjalëve sipas gjedhesh ekzistuese fjalëformimi, përngjitja është një mënyrë fjalëformimi që nuk mbështetet në gjedhe të njohura¹⁰. Duke qenë formime spontane, fjalët e përngjitura janë tipike për ligjërimin e folur, prandaj edhe hasen në shtresën më të vjetër të leksikut të shqipes, duke përbërë një pjesë të konsiderueshme të tij. Fjalët e një sintagme, duke u shkrirë në një fjalë të vetme, humbin kuptimin leksikor e theksin, kurse sintagma, duke u njëfjalësuar humbet intonacionin, ndërsa theksi i saj, që bie në fjalën e fundit, kthehet në theks të fjalës së përngjitur. Kjo duket qartë sidomos në fjalë të vjetra, si *farefis*, *gjëgjëzë*, *kushtrim*, *kryeshëndoshë*, *ndeshtrashë*, *mirupafshim*, *shtojzovalle*, *tungjatjeta*, *tumirëmbëç* etj., që janë fjalë të fondit aktiv të shqipes, po edhe në shumë fjalë të tjera të përngjitura që hasen në të folme të shqipes, si *ashtupóti* (nga *ashtu*, *po ti*, përgjigje në Labërinë e brendshme ndaj pyetjes përsëritëse *Si u gdhive/ngryse/erre!*), *kojđu* (ku e di unë), *ndukegerb* “ha duke kafshuar bukën dhe duke pirë lëngun”; *shati* (qafsha ti (ty)), *shavëllanë* (qafsha vëllanë) në Himarë; *quati* (që thua ti) tek Ali Asllani) etj.

Hyjnë këtu, së pari, lidhëzat e përngjitura, që vijnë nga njëfjalëzimi i sintagmave parafjalore ose lidhëzore dy- ose trifjalëshe, të cilat janë shkuptimësuar, madje disa në atë shkallë sa është e vështirë t’u nxirret kuptimi, si: *gjithsaherë*, *josemë*, *kurse*, *megjithatë*, *megjithëkëtë*, *megjithëqë*, *megjithëse*, *meqë*, *mësa*, *ndërsa*, *ndonëse*, *nëse*, *posi*, *që kurse*, *sado*, *sadoqë*, *sadomos*, *saqë*, *sido*, *sikundër*, *sikur*, *sepse*, *tekqë*, *teksa* etj.¹¹ Pastaj vijnë një

¹⁰ Shih: A. Kostallari, *Disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe* në “Studime mbi leksikon dhe fjalëformimin në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, f. 85.

¹¹ Megjithatë, lidhëzat e përngjitura prej tri pjesësh në fjalorët normativë të shqipes jepen përgjithësisht me theksin mbi fjalën e parafundit, si p.sh.: *megjithatë*, *megjithëkëtë*, *megjithëqë*, *megjithëse*, *meqënëqë*, *meqënëse*, *ndonëse*, *përvécqë*, *përvécse*, *qëkurse*, *sadoqë*, *sikundërqë*, *sikundërse*, me përjashtim të lidhëzave *gjithsaherë*, *josemë*, *posaqë*, *sadomós*, *sikursé*, të cilat, edhe pse kanë strukturë të ngjashme me të parat, jepen me theks mbi fjalën e fundit (Shih: *Fjalor i gjuhës së*

numër i madh përemrash të pacaktuar, si: *akëcili, çfarëdo, kushdo, akëkush, akëcili, akësecili, akësekush, asfarëgjë, asgjë, asgjëkafshë, asgjësendi, askurrfarë, asndonjë, asndonjëri, asnjeri, asnjë, asnjëfarë, asnjëfarëlloj e asnjëri* (vetëm te shkronja A e fjalorit); dhe ndajfoljesh, si: *afermendsh, akëku, akëqysh, akëseku, anamend, anapraptas, anaprapthi, andej, andejpari, anekënd, anembanë, anepërçark, aneqark, anëpëranë, asajane, asfare, asgjetiu, asgjëkund, asisoj, askund, askurrë, askurrkah, askurrkund, asndonjëherë, asnjëherë, asohere, asokohe, aspak, assesi, atëherë, atëkohë, atypari* (vetëm te shkronja A e fjalorit).

Nuk do të merremi këtu me fjalë të përngjitura të klasave të tjera, si numërorët, parafjalët, pjesëzat, pasthirrmat etj., të regjistruara në fjalorët e shqipes¹², pasi kjo nuk përbën objektin e këtij kumtimi. Ajo që na intereson është të vëmë në dukje se kjo klasë fjalësh po vijon të pasurohet me njësi të reja. Kështu, në korpusin e vjelë prej nesh, të tilla fjalë të reja të përngjitura janë përemrat e pacaktuar *cilidoqoftë* (cilidoqoftë rezultati) e *çfarëdoqoftë* (çfarëdoqoftë tjetër); ndajfoljet *herëdokur* “dikur, njëherë” (populli dhe shteti i Kosovës duhet t’i kthejnë herëdokur këto ndërmarrje), *qyçeliga* e *vetëmevete*¹³; mbiemrat *bardheblu, bregfildishtas* (Bregu i Fildishtë), *kushedisavjeçar* (gjelbërimi *kushedisavjeçar*), *tetëdhjetecavjeçar, tetë-e-mëshumëvjeçar* (ëndërr tetë-e-mëshumëvjeçare), *briskpavënë, gjakpangopur, hajërpararë, kthetrapadalë, thonjaprerë e zorrëpafryrë* (që përdoren edhe si emra); folja *vejevij* “bëj ecejake”; dhe emrat *mutehira* “gjëra pa vlerë”, *katërherëkampion* (katërherëkampioni i botës) e maocedunide.

5. Kompozimi është mënyra tjetër e fjalëformimit ku shfaqet prirja për sintetizëm, që sjell ekonomi gjuhësore duke zëvendësuar sintagma me fjalë të vetme. Përfitimi këtu është në disa rrafshë: në rrafshin fonetik, nga një sintagmë dyfjalëshe, me dy nivele theksash dhe me intonacion, përftohet një fjalë e vetme, me një nivel theksi; në planin morfologjik, kemi eptim jo të secilit përbërës si te sintagma, po të kompozitës si njësi e tërë, pra vetëm me një formant eptimor, që, me pak përjashtime, e ka vendin pas temës së dytë të kompozitës; në planin sintaksor, lidhja e fjalës së përbërë me gjymtyrën

sotme shqipe, Tiranë, 1980; *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006). Theksimi mbi fjalën e parafundit jo vetëm që thyen rregullën e theksimit të fjalëve të përngjitura, por krijon edhe probleme drejtshkrimi te lidhëzat *megjithatë, megjithëkëtë, megjithëqë, meqënëqë, përveçqë, sikundërqë*, të cilat duhen shkruar pa këtë ë fundore, meqë kjo zanore e patheksuar del dy rrokje pas theksit.

¹² Për listën e fjalëve të përngjitura të të gjitha klasave, shih L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, Botimet Kumi, Tiranë, 2009, f. 294–312.

¹³ Fjalët *herëdokur* dhe *vetëmevete* dëshmohen që para vitit 2009 (shih L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura...*, f. 307 dhe 312).

paraprijëse është më e thjeshtë dhe nuk kërkon energji mendore (të kujtuarit e rregullave për përdorimin e nyjës), siç nevojiten kur sintagma dyfjalëshe gjegjëse e kompozitës lidhet me një paraprijës. P.sh., ndërtimi i sintagmave foljore *u kap vrasësi i prindit*, *e kapën vrasësin e prindit*, *e kapën vrasësen e prindit*, *vrasëses së prindit* *iu dha dënimi*, kërkon jo vetëm caktimin e rasës emërore apo kallëzore emrit *vrasës / vrasëse*, po edhe drejtimin nëpërmjet nyjës së përparme të emrit të dytë nga emri i parë. Pra, kemi dy operacione sintaksore, nga të cilët i dyti është më i vështirë, sepse ka të bëjë me përshtatjen e nyjës në numër dhe gjini me emrin paraprijës, që për emrat femërorë paraqitet edhe më i ndërlikuar për shkak të ngatërimit të saj me nyjën gjegjëse të emrave mashkullorë. Kur në vend të sintagmës emërore përdoret kompozita gjegjëse, nevojitet vetëm një operacion sintaksor, caktimi i rasës emrit nga folja, pra *u kap prindvrasësi*, *e kapën prindvrasësin*, *u kap prindvrasësja*, *e kapën prindvrasësen*. Por përdorimi i më pak operacioneve sintaksore do të thotë harxhim më i pakët energjish mendore dhe, ndonëse me forma sintetike (kompozita) në vend të formave analitike (sintagma) rritet shkalla e abstraksionit, pasi folësit i duhet t'i drejtohet formës së thellë të kompozitës, prapëseprapë përfitimi është i madh.

Në korpusin tonë të fjalëve të reja, kompozimi del si mënyra më prodhimtare e fjalëformimit, me fjalë të përbëra të formuara sipas gjedheve ekzistuese të shqipes, por me denduri jo të njëjtë të përdorimit këtyre gjedheve. Ndër klasat e fjalëve të formuara me kompozim, mbizotërojnë emrat dhe mbiemrat, ndërsa kompozitat foljore janë të rralla.

Vendin e parë si për nga tipat edhe për nga numri e zënë kompozitat emërore. Në këto kompozita, tema e parë është përgjithësisht emër, por edhe ndajfolje, ndërsa tema e dytë është gjithnjë emër. Kjo temë e dytë përcakton edhe kuptimin kategorial të fjalës së përbërë, pra del si kokë leksikore e kompozitës, në përputhje me natyrën e shqipes që te kompozitat e ka kokën djathtas. Duke i marrë fillimisht sipas natyrës leksiko-gramatikore të përbërësit të dytë, kompozitat emërore janë disa tipash.

a) Kompozita të tipit *emër + emër veprimi*, në të cilat tema e parë “përcakton të dytën duke i shërbyer si objekt veprimi”¹⁴, si: *baltëhedhje* “baltosje”¹⁵, *drugdhëndje*, *duhanpírje*, *dhëmbëzbardhje* “zgërdhirje”, *fjalëmbajtje*, *gojështhurje*, *shpirttronditje*, *bletërritje*, *shpendrritje*, *rrugëgjetje*, *qeveribërje*, *prindvrasje*, *paqeruajtje*, *lartësimatje*, *kohëngjizje*, *pushtetmarrje*, *radiombrojtje*; *botëkrijím*, *frymëkëmbim* “frymëmarrje artificiale”, *historishkrim*, *shtetndërtim*. Këta emra të përbërë vijnë nga sintagma emërore të tipit emër në emërore + emër foljor në gjinore, p.sh.

¹⁴ L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, f. 148.

¹⁵ Kompozita *baltëhedhje* mund të merret më fort si formim nga shprehja foljore *hedh baltë*, ashtu si *frymëmarrje* rrjedh nga *marr frymë* etj.

drugdhendje (gdhendje e drurit), *duhanpirje* (pirje e duhanit), *frymëkëmbim* (këmbim i frymës) etj.; ndërsa *radiombrojtje* vjen nga një sintagmë e tipit emër + sintagmë parafjalore me parafjalën *me* (mbrojtje me radio).

b) Kompozita të tipit *emër + emër*, që janë barasvlerëse të sintagmave të tipit emër + emër në rrjedhore të pashquar, një pjesë e tyre edhe si faza e fundit e procesit të kalimit nga përngjitja te kompozimi¹⁶, përfundimin e të cilit e shënon humbja e treguesit gramatikor. Kompozitat e këtij lloji të korpusit tonë kanë si pjesë të dytë kryesisht emra me prapashtesat *-im* dhe *-je*. Të tilla janë *arkëmort* (arkë morti), *grushtshtet*, *gurvárr*, *leshsheqer*, “sheqer i djegur i bërë si shtëllungë leshi për fëmijë”; *këmishënatë* (këmishë nate, Kadare)¹⁷; *datëthemelim* (datë themelimi), *malakull* “ajsberg”, *planveprim*, *urdhërveprim*, *venddepozitim*, *vendfurnizim*, *vendnumërim* “vend numërimi votash”, *vitthemelim*; *aktvdëkje* (akt vdekjeje), *ditëvdekje*, *dorëzgatje*, *planvendosje*, *vendvrasje*, *vijëmbrojtje*.

c) Kompozita të tipit *emër + emër vepruesi*, në të cilat gjymtyra e parë përcakton të dytën, që shërben si kokë e fjalës së përbërë. Të tilla janë *breshërndalues* “raketë kundër breshrit” (ndalues i breshrit), *balenagjuajtëse* (gjuajtëse balenash), *kaladërrmues*, *ligjhartues*, *mashkullxhirues* (mekanikë), *ligjhartues*, *punëkërkues*, *qytetpushtues*, *referendumkundërshtues*, *referendumpropozues*; *borderofirmosës* “ai që paguhet kot” (firmosës i borderosë), *dherráhës* “mërgimtar”, *fjalimmbajtës*, *kallamlëpirës*, *kolllukmbajtës*, *krimkryerës*, *moralbërës*, *pavarësibërës*, *plagosmbartës*, *prindvrasës*, *qymyrbartës*, *qymyrnxjerrës*, *radiofolës*, *referendummbështetës*, *rërëshpërndardëse*, *spiunbërës*, *shigjetëhedhës*, *shishembajtëse*, *ujëprurës*, *ujëhedhës*, *vajmbajtëse*, *valvulshtytës*.

¹⁶ Në kompozita të tilla A. Kostallari sheh “një proces të pambaruar kalimi nga një fjalë e bashkëngjitur në një fjalë të përbërë me përcaktim rasor” (*Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe* në “Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 83–84. Sipas tij, “me njëfjalësimin e sintagmave të tipit *vend kalimi* (trajta e shquar *vendi i kalimit*), domethënë me krijimin e fjalëve të përbëra të tipit *vendkalim-i*, marrëdhëniet sintaksore ndërmjet fjalëve *vend* e *kalim* (përkatësisht edhe marrëdhëniet ndërmjet nocioneve që shënohen prej tyre), që në sintagmë shpreheshin *drejtpërdrejt* me tregues rasorë të tipit sintetik e analitik (në trajtën e pashquar me treguesin *-i* të rrjedhore dhe në trajtën e shquar me nyjën e përparme *i* të gjinore e me mbaresën *-t* njëkohësisht), nuk shprehen më *drejtpërdrejt*, por dalin sipas vendit të përbërësve *në mënyrë të ndërmjetuar kuptimisht*, treguesit e drejtpërdrejtë mënjanohehen dhe krijohet një *strukturë e mbyllur sintetike*, e cila hyn në marrëdhënie me njësitë e tjera të leksikut *si njësi e vetme e tërësore* (krhs. *vendi i kalimit të këmbësorëve* dhe *vendkalimi i këmbësorëve*)” (A. Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit...*, art. i cit., f. 25).

¹⁷ Te *këmishënatë*, tregues i njëfjalësimi është errësimi i mbaresës rasore *e* në *ë*, që është tregues i gjinisë femërore të kompozitës.

ç) Kompozita të tipit *emër + emër me lidhje përcaktore-ndajshimore* të përbërësve. Të tilla janë *aeroplan-cisternë, aeroplan-lodër, aeroplan-taksi, autobus-bibliotekë, autobus-fizarmonikë, autobus -taksi, avion-raketë, banesë-kështjellë, bar-restorant, breshkë-lodër, çakmak-pistoletë, çadër-pistoletë, furgon-taksi, hotel-kazino, kamion-cisternë, krimb-turjelë, makinë-bombë, makinë-lodër, njeri-bombë, parti-shtet, pushkë-lodër, qytet-kështjellë, qytet-perlë, projekt-pilot, qytet-port, qytet-satelit, qytet-skelë, revole-lodër, shtet-komb, shi-acid, shi-meteor, shkop-shpatë, shtet-ishull, shtet-komb, tank-lodër, thikë-sharrë, vagon-sallon.*

Ky tip kompozitash është duke u bërë gjithnjë e më prodhues në shqipen e sotme, ndonëse paraqet njëfarë anomalie në krahasim me tipat e tjerë, pasi, ndryshe nga këta tipa, në të cilët treguesit gramatikorë dalin në fund të kompozitës, në fjalët e përbëra me lidhje përcaktore-ndajshimore, treguesit gramatikorë i ka gjymtyra e parë, p.sh.: *aeroplan-cisternë, ~i-~ m., sh. ~ë-~, ~ët-~.*

d) Kompozita me lidhje përcaktore të tipit *emër + emër, kryeadjutánt, kryeagjént, kryeakademík, kryeanalíst, kryeargumént, kryeaventuriér, kryebajlóz, kryebajrák, kryebajraktár, kryebukëpjékës, kryeçështje, kryedialékt, kryediplomat, kryedjáll, kryedoganiér, kryedukat, kryedukeshë, kryedhespót, kryeekonomíst, kryefaqe “faqja e parë e gazetës”, kryefé, kryefizioterapist, kryehetúes, kryeideatór, kryeinstruktór, kryeinstrumentíst, kryekomisár, kryekompozitór, kryekomunár, kryekonferenciér, kryekontrollór, kryekoordinatór, kryekriminél, kryekujdestár, kryelájim, kryelíbër, kryeligésí, kryemafióz, kryemblédhje, kryemenaxhér, kryemík, kryemotoríst, kryemúaj, kryendëshje, kryeoborrtár, kryeopozítar, kryeorganizatór, kryepajtúes, kryepár, “i pari i një bashkësie”, kryeplanifikúes, kryepolic, kryepriftéri, kryeprofét, kryeprojekt, kryepushtetár, kryeqeverítar, kryerrëfimtár, kryesenatór, kryesindikalist, kryesinjalizúes, “nënoficer i flotës” kryespiún, kryestratég, kryeshékull, kryeshénjë, kryeshénjt, kryeshétetas, kryeterroríst, kryetráshë, kryeustá, kryevariánt, kryevëzhgúes dhe kryevlérë, projektprogram, projektplatformë, projekttram, projektport, projekttrregullore, zëvendësambasador, zëvendësdekane, zëvendësdrejtore, zëvendës guvernator, zëvendëskancelar, zëvendëskonsull, zëvendësndihmëssekretar, zëvendësrektore, zëvendësshëf etj.* Kompozitat emërore me temë të parë një pjesë të trupit të njeriut janë duke u bërë edhe më shumë prodhimtare, duke qenë se, të paktën, çdo emër njeriu sipas mjeshtërisë mund të bashkohet me tema të tilla. Kjo shtron para leksikografit detyrën e vështirë të përcaktimit të një pragu për paraqitjen në fjalor të kompozitave të tilla.

dh) Kompozita të tipit *ndajfolje + emër*, ku ndajfolja shërben si gjymtyrë përcaktuese, ndërsa emri si kokë leksikore e fjalës së përbërë. Kjo gjedhe fjalëformimi është më pak prodhuese se gjedhet e mësipërme. Të tilla

janë: *keqndërtim, keqprojektim, keqpërfaqësim, bashkëkryeministër, barsafajësim; prapavendosje dhe prapangelje.*

e) Kompozitat me lidhje këpujore përfshijnë një grup shumë të vogël fjalësh, çka tregon se ky tip fjalësh nuk është aq prodhues për klasën e emrit. Të tilla janë *humbaudhas* “humbameno, humbalaq”, e formuar nga një folje dhe një emër me lidhëzën këpujore *a*, sipas gjedhes *djegagur*, dhe ato të tipit *emër + emër* me zanoren lidhëse *-o-*: *ozonosferë, pushtetomani, sintaksostilistikë*; ose pa zanore lidhëse: *ikje-ardhje, kërkesë-ofertë, ngjitje-zbritje, nikel-silikat, ortopedi-traumatologji, pastrim-gjelbërim, peshk-glob, peshk-gjilpërë, stabilizim-asocim, tatim-taksat, kripëpiperosje e ferrparajsë.*

ë) Një numër i vogël kompozitash emërore, si *pilotbalonë* “pilot balone”, *rrobarojas* “punëtor gardërobe” e *mbarslise* “juga e bardhë”, nga emërzimi i sintagmës foljore *mbars lisiin*, shfaqen si raste përjashtimore.

f) Më në fund, haset edhe një kategori emrash të përbërë të tipit siparashtesë + emër, përbërësi i parë i të cilave është *agro-, akua-, auto-, avio-, eko-, makro-, maksi, mikro, mini-, pseudo-, sizmo-, soc-*, si: *agromjedis, agropërpunim, agroturizëm, akuakulturë; autolarje, autogoma, autopjesë, autotreg, autoshërbim* (në kompozita të tilla, elementi *auto-* është shkurtim i *automobil*); *avioregjiment, ekomafie, ekodéng, ekokatastrófë; makrostrategji, maksifund, minifund, progresraport* (edhe raportprogres), *pseudoproblem, pseudoprogram, pseudoprotestë, pseudorilindës*, “rilindës i gënjeshtërt, i rremë”, *sizmoteknikë, socrealist, socrealizëm, radioburim, radiodiagnostikë, radioelement, radiofener, radiogoniometri, radiokompani, radiokomunikim, radiofolës, radiokronist, radioorientim, radioshenjë, radiotaksi, radioteleskopi, radiozgjim* etj. Ky tip kompozitash, sikundër vë në dukje edhe Sh. Islamaj, po vjen duke u bërë shumë prodhimtar në ditët tona¹⁸.

Pas emrit, mbiemri është pjesa e dytë e ligjëratës që po pasurohet me shpejtësi me njësi të reja, duke shfrytëzuar si një nga gjedhet më prodhuese kompozimin. Në korpusin tonë shpërfaqen këta tipa të kompozitave mbiemërore:

a) Mbiemra të tipit *emër + mbiemër prejppjesor me -s*, që dalin si tipi më prodhimtar. Mbiemra të tillë janë *botëzotërues, drejtësiushtrues, drejtimdëftues, drejtimtregues, fatcaktues, fëmijëmohues, fjalimshkrues, historindryshues, kategoriformues, komunitetndërtues, ligjzbatues, mendimngacmues, mesazhshkrues, ozonhollues, raketalëshues, shajnishkaktues* “që shkakton halucinacione”, *shtetndërtues; atdhembrojtëse* “e drejta atdhembrojtëse”, *fondmbledhës, idepërçues, kombdashës, lavdithurës,*

¹⁸ Sh. Islamaj, *Prirje fjalëformuese në kontekstin e ri sociolinguistik* në “Gjuha, teksti dhe konteksti”, Prishtinë, 2014, f. 120.

magjiprishës, mesazhmarrës, njerëzdashës, pritëzënës, politikëbërës, punëprishës, rërëshpërndarës, stuhimbledhës, ujëzbutës, vdekjendjellës etj. Veçori e gjymtyrës së dytë të kompozitave të këtij tipi është se këto fjalë kanë aftësinë të funksionojnë edhe si emra, edhe si mbiemra, kështu që edhe fjalët e përbëra të formuara prej tyre mund të merren edhe si kompozita mbiemërore, edhe si kompozita emërore, çka do të thotë se mund të motivohen në dy mënyra: si emra të përbërë me lidhje përcaktore, gjymtyra e parë e të cilëve përcakton të dytën, p.sh.: *botëzotërues* (zotërues i botës), *politikëbërës* (bërës i politikës) etj.; si mbiemra, përsëri gjymtyra e dytë përcakton të parën, po motivimi është i ndryshëm: *botëzotërues* (që zotëron botën), *drejtësiushtrues* (që ushtron drejtësi) etj. Por prania e një teme të dytë që të shumtën e herës funksionon edhe si emër, edhe si mbiemër, e bën të vështirë dallimin e përkatësisë leksiko-gramatikore të këtyre kompozitave jashtë kontekstit.

b) Mbiemrat e tipit *emër + mbiemër prejpjesor* shfaqen mjaft prodhimtarë në shqipen e sotme. Të tilla janë kompozitat *borëmbuluar, buzëqeshjegrisur, djersëlarë, dyshemegjakosur* (thertore dyshemegjakosur), *hijendritur, hijezbrazur, historindritur, jetëmbyllur* (nënat jetëmbyllura), *karrigethyer* “që ka rënë nga pozita”, *kallirënduar, këmbëzhveshur, kokëzbathur, kryevenitur, kryezhyt, majëkëputur, majëthyer, mendjehupur, mendjeshkrehur, mendjetredhur, stuhirrahur, shijehollë, shitimmadh* “që e kanë shituar”, *udhëhumbur, ujëkulluar dhe vesëqullur*. Koka mbiemërore është gjymtyra e përcaktuar e këtyre kompozitave, p.sh.: *borëmbuluar* (që është i mbuluar nga bora), *jetëmbyllur* (që i është mbyllur jeta) etj.

c) Mbiemra të tipit *emër + mbiemër* janë në numër të kufizuar. Si të tillë në korpusin e vjelë dalin mbiemrat e përbërë *flatraargjendtë, flatraartë, flatralintë, bokëbárdhë, kokërrallë, ngjyrëndryshueshëm*, në të cilët emri është elementi i përcaktuar, kurse mbiemri elementi përcaktues, p.sh.: *flatraargjendtë* (që i ka flatrat të argjendta), *bokëbardhë* “që është me gurë boke”, *këmishëçelikutë, këmishëjashtë, mendjeçiltër, mendjeftohtë, mendjekallp, meseuropian, mesoqeanik, ngjyrëndryshueshëm* (që ndryshon ngjyrë), *pushkëmizor, qostekartë, qoshemprehtë* etj.

ç) Mbiemrat ekzocentrikë të tipit *emër + emër* janë *trugomar, faqegurabi e ngjyrëjargavan*. Motivimi i tyre bëhet nëpërmjet emrit të dytë, një cilësie të spikatur të këtij emri, p.sh.: *trugomar* (që ka tru sa të gomarit”, *faqegurabi* (që i ka faqet si gurabi), *kokëtapë, mendjefëmijë, mendjefoshnjë, ngjyrëjargavan* (që e ka ngjyrën si të jargavanit)¹⁹, *ngjyrënenë*. Pikërisht, kjo

¹⁹ Mbiemri *ngjyrëjargavan* mund të shihet edhe si i formuar nga njëfjalësimi i sintagmës *ngjyrë jargavani*, shoqëruar me humbjen e mbarsës rasore -i.

cilësi është arsyeja pse ky emër mund të shihet edhe si kokë leksikore e kompozitës, d.m.th. që kompozita të shihet si endocentrike²⁰.

d) Mbiemrat e tipit *emër + ndajfolje* përbëjnë një klasë mbiemrash që “janë përdorur dendur gjatë kohës së Rilindjes”²¹, rezultojnë prodhimtare edhe vitet e fundit. Të tillë mbiemra që dalin në korpusin tonë janë *dinjitetshumë, dhimbjeshumë, fshehtësiplotë, kallirënduar, karakterdobët, karrigethyer, këngëshumë, kohëpjesshëm* “që bëhet pa shkëputje nga puna”, *kohëplotë* “që bëhet me shkëputje nga puna”, *kryepërpjetë* “mendjemadh”, *majëpërpjetë, motivpastër* (ide qëllimmira e motivpastra), *mrekulliplotë, qëllimmirë, ujëshumë*. Këto kompozita, ku ndajfolja është elementi përcaktues, duken si ekzocentrike, por, në të vërtetë, janë endocentrike, për arsye se ndajfolja është një klasë fjalësh shumë e ngjashme me mbiemrin²².

dh) Mbiemrat e tipit *ndajfolje + mbiemër* në korpusin tonë përfaqësohen me fjalët *brendapartiak, brendashqiptar, brendashtetëror, kaqyjeçar, i lartcekur* “i lartpërmendur”, *i lartshkruar* “argument i lartshkruar”, *i rëndëngarkuar* “vite të rëndëngarkuara”, *i sipërevidentuar, i sipërjetshëm, i sipërtheksuar, i shumëçmuar, i shumëdebatuar, i shumëdëmtuar, i shumëdiskutuar, i shumëkritikuar, i shumëlakmuar, i shumënjohur, i shumëpërfolur, i shumëpërhapur, i shumëtutë, i shumëvlerësuar, i shuminformuar; shumëdimensional, shumëmëror, shumëfaktorial, shumëkilometrik, shumëmuajor, shumëracor, shumëpërmasor* etj. Si një nëntip i veçantë mund të merren kompozitat që gjymtyrën e parë e kanë numëror, si p.sh. *njëmëror*.

e) Kompozita të tipit siparafjalë + mbiemër, me element të parë elementet fjalëformuese *agro-, makro-, mikro-, sizmo-*, si: *agroushqimor, mikrofinanciar, makrofiskal, makromolekular, makropolitik, makroproces, makrorajon, makrosizmik, sizmotektonik*,

Ka edhe kompozita mbiemërore të formuara me lidhje bashkërenditëse, me ose pa zanoren lidhëse *-o-*, si *korrrëse-lidhëse* (makinë korrrëse-lidhëse),

²⁰ Në literaturën tonë gjuhësore si kompozita ekzocentrike janë marrë edhe fjalët e përbëra të tipit emër + mbiemër, si *zemërbardhë, vetullhollë, buzëbardhë, mustaqezi* etj. (A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe* në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, f. 89–90). Në të vërtetë, qysh nga L. Blumfildi, endocentrike quhen ato ndërtime sintaksore të cilat “i përkasin së njëjtës klase formale si koka a bërthama e tyre” dhe kryejnë të njëjtat funksione si koka e tyre, kurse ekzocentrike “frazat të cilat nuk i përkasin klasës formale të asnjërit prej përbërësve” (L. Bloomfield, *Language* 1933, f. 194).

²¹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, vep. e cit., f. 200.

²² Pikërisht për shkak se mbiemrat dhe ndajfoljet, si fjalë që tregojnë cilësi, ndërkëmbehen me njëri-tjetrin, në gramatikën gjenerative ndajfoljet nuk numërohen si kategori leksikore dhe as flitet për sintagma ndajfoljore.

magjiko-ritual, mesdhetaro-ballkanik, strategjiko-operativ, por edhe pa zanore lidhëse, si *bardhëkuq*

Sikundër dihet, formimet foljore me kompozim janë të rralla²³. Edhe në korpusin tonë kompozitat foljore janë të pakta dhe të formuara të gjitha sipas gjedhes *ndajfolje + folje*, kryesisht me ndajfoljet *bashkë, keq e mirë: bashkëdrejtoj, bashkëgojëztoj, bashkëkoordinoj, bashkëpilotoj, bashkëqeveris, disafishoj, drejtvendos, keqdegjoj, keqdrejtoj, keqfaturoj, keqkëshilloj, keqmenaxhoj, passjell* “sjell më pas”, *kundërqëndroj* “kundërvihem”, *mirëdukoj, mirëdetajoj, mirëzbatoj, mirideoj*,

6. Numri shumë i madh i kompozitave në korpusin e shqyrtuar dëshmon për një teprim në përdorimin e tyre që nuk buron nga nevojat e shqipes, pasi kjo i ka tashmë mjetet leksikore për përmbushjen e këtyre nevojave. Shkaqet e përdorimit të kompozitave të panevojshme ose të kompozitave të ndërtuara jo sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes duhen kërkuar sa në mosnjohjen e pasurisë leksikore të saj, aq edhe në paaftësinë e atij që shkruan për t’i përpunuar idetë dhe për të gjetur mënyra alternative të shprehjes së tyre. Folësi që nuk i zotëron në shkallë të mjaftueshme këto mjete leksikore e mënyra shprehjeje të ideve, mundohet t’i kompensojë duke përdorur fjalë të “mëdha”.

Si shembull kompozitash që mund t’i quajmë shëmti gjuhësore, do të numëronim fjalët *draftrezolutë, draftprojekt* (draftprojekt për rritjen e moshës) e *draftrrregullore*, të shkruara diku ndaras e diku me vizë në mes; *sllavorusoserb*, me vizë ose bashkë; *sllavo-komunizëm* (të shkëpusim vendin nga sllavo-komunizmi), *tejqepërdorur, keqmirëmbajtje, tentativëvrasje* (vrasjet dhe tentativëvrasjet), *tokëlëkundje* në vend të tërmet, *vendnumëroj, skipistë* për pistë skish. Në shqipe kanë zënë vend prej kohësh fjala *projekt* dhe rrjedhojat e saj *projektrezolutë, projektrregullore, projektprogram* etj.; ndërsa *draftprojekt*, dmth. *projektprojekt*, përbën një monstër leksikore. Fjalët *sllavorusoserb* e *sllavo-komunizëm* të shtypit nuk janë ndërtuar sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes, sepse nuk ka në shqipe mbiemra të përbërë me temë të dytë një kompozitë, as kompozita emërore të tipit mbiemër + emër. E ndërtuar sipas gjedhesh të huaja është edhe *skipistë* për *pistë skish*. Kompozita *keqmirëmbajtje*, nuk qëndron logjikisht, sepse vërtet që antonim *i mirë* është *keq*, por e kundërta e kompozitës *mirëmbajtje* është *mosmirëmbajtje*. Natyrisht, nuk mund të zëvendësohen të gjitha sintagmat emërore, mbiemërore e foljore me fjalë të përbëra, pra do të vijojmë të themi dhe të shkruajmë *lëkundje të tokës, numëroj në vend, i formuar si duhet e pistë skish* dhe jo *tokëlëkundje, vendnumëroj, i mirëformuar e skipistë*.

²³ Shih: *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, vep. e cit., f. 354, § 7.22.7.

BIBLIOGRAFI

- Agalliu, F., Memushaj, R., Reso, M., *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 1986.
- Bloomfield, L. (1933), *Language*, The University of Chicago Press, Chicago and London, 1984.
- Buxheli, L., *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, Botimet Kumi, Tiranë, 2009.
- Dhrimo, A., Memushaj, R., *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë, 2015.
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, Tiranë, 1976.
- Islamaj, Sh., *Prirje fjalëformuese në kontekstin e ri sociolinguistik në “Gjuha, teksti dhe konteksti”*, Prishtinë, 2014.
- Kostallari, A., *Disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe në “Studime mbi leksikon dhe fjalëformimin në gjuhën shqipe”*, I, Tiranë, 1972.
- Kostallari, A., *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, SF, 1982, 2.
- Kostallari, A., *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, Studime filologjike, 1970, 2.
- Sapir, E., *Language*, Harcourt, Brace & World, Inc., New York, 1921.
- Schlegel, A. W., *Observations sur la langue et la littérature provençales*, 1818.
- Schwegler, A., *Analyticity and syntheticity*, Mouton de Gruyter, Berlin . New York, 1990.
- Thomai, J., *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.
- Vennemann, Th., *Agglutination – Isolation – Flexion? Zur Stimmigkeit typologischer Parameter* në S. Heinz and U. Wandruszka (eds.), *Fakten und Theorien: Beiträge zur romanischen und allgemeinen Sprachwissenschaft: Festschrift für Helmut Stimm zum 65. Geburtstag*, Tübingen (Gunter Narr), 1982.
- Zipf, G. K., *Human Behaviour and the Principle of the Least Effort*, Addison-Wesley Press Inc., Cambridge, Massachusetts, 1949.

SUMMARY**SYNTHETISM AS A FEATURE OF WORD-FORMATION PROCESSES IN ALBANIAN LANGUAGE**

In albanian grammatical tradition it is generally thought that synthetism is a feature of inflection. But this opinion does not hold true, because

synthetism plays an important role not only in the inflectional morphology of Albanian, but also in its lexical morphology. Its role has been expounded by A. Kostallari in his writings about word-formation of Albanian.

The author of this paper, based on a corpus of 7 thousand new words of the second publication of his “Orthographic dictionary of Albanian language” (2015), is making an effort to show that the coining of new words by affixation of the whole phrases and composition are the two main manners of enriching the vocabulary of Albanian.

The most productive patterns of word-formation in Albanian remain suffixation and composition. Among the types of coining new derived words is prefixation of the adjective preposed article to a phrase, as in the cases *i aqshumëgjakosur* [i (aq shumë i gjakosur)]; infixation as in *i shumëfrytshëm* [i + (shumë) frytshëm], *i mirëplanifikuar* [i + (mirë) planifikuar] etc; circumfixation, as in the cases *i njëpalshëm* [i + (një palë) + -shëm], *i kotsëkotshëm* [i +(kot së koti) +-shëm]. Suffixation is also an active and productive way of word-formation. The most productive suffixes are *-(r)isht* and *-shëm* used to coin adverbs, and *-ësh*, *-(ë)ri* and *-(ë)si* used to form abstract nouns of quality. But the most productive word-formation pattern is composition that offers many possibilities of connection of stems of different classes, such as: *noun + noun* (*këmishënatë*, *vendfurnizim* etj. that derive from nominal phrases), *noun + nomen actionis* (*drugdhendje*, *duhanpirje*), *noun + nomen agentis* (*ligjhartues*, *qymyrbartës*), *noun + noun* (with appositional relation: *aeroplan-cisternë*, *hotel-kazino* etc.), *noun + noun* (with determinative relation: *kryebajloz*, *projektrregullore* etj.), *noun + participial adjective* (*kombdashës*, *kallirënduar*), *exocentric compounds* (*faqegurabi*, *trugomar*), etc., etc. These types of word-formation are very productive and active at nouns and adjectives, and in a lesser degree at adverbs and verbs.

The author notices also a growing tendency, especially in the language of media, to coin compound words that are not necessary, such as *draftrregullore* vs. the existing *projektrregullore*, *dhelëkundje* vs. *tërmet*, *keqmirëmbajtje* vs. *mosmirëmbajtje* etc. Albanian has actually the words that express these concepts, so it is not necessary to devise new words for them. This exaggerated tendency to coin new compounds without any need does not contribute to the enriching of the vocabulary of Albanian. This goes to the detriment of our language, especially if the coining of new words does not respect the patterns and means of word-formation of our language.

